

VENDIM
Nr.31, datë 19.5.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR LICENCIM NË
AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA H/C EGNATIA, KOMUNA HOTOLISHT, LIBRAZH, D,
TË “REMI” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11 germa “A”, si dhe neneve 10 pika 2 dhe 14 pika 2 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 4.4.2007 “Rregullat për procedurat e licencimit”, të ndryshuar, Bordin i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 19.5.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Remi” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Egnatia, komuna Hotolisht, Librazhd

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të “Remi” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ana e tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta